

eppc kërkon një *Menaxher Rrjeti Restorantesh* për klientin e saj i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në vend.

MUNDËSIA JUAJ

Klienti është në kërkim të një kandidati i cili duhet të ketë përvojë në menaxhimin e restoranteve. Ai/Ajo do të jetë përgjegjës për të mbajtur standardet më të mira të ushqimit, shërbimit, shëndetit, sigurisë në punë, si edhe për performancën financiare.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Plotëson nevojat e restoranteve me staf, duke përzgjedhur, trajnuar, monitoruar dhe vlerësuar punën e tyre nëpërmjet dhënies së feedback-ut të vazhdueshëm;
- Përgatit plane konkrete me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të restoranteve;
- Përgatit buxhetin vjetor, identifikon dhe vlerëson risqet dhe shpenzimet, arrin objektivat financiarë;
- Inkurajon klientët biznese për të organizuar festa dhe eventet e tyre në restorantet që menaxhon;
- Drejton dhe monitoron fushatat e marketingut;
- Monitoron dhe mirëmban ambientet si dhe shërbimet e ofruara;
- Kujdeset të mbajë një ambient pune të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe cilësor.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare, e preferueshme në Menaxhim dhe/ose Administrim Biznes;
- Përvojë e mëparshme në menaxhim restorantesh apo baresh jo më pak se 5 vjet;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi drejtuese, udhëheqëse, organizative dhe vendimmarrëse;
- Integritet, dhe besueshmëri profesionale;
- Përgjegjshmëri dhe qëndrim korrekt me stafin.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher Rrjeti Restorantesh;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	45 orë në javë;
Pagesa:	Pagë në nivel drejtuesi;
Përfitime te tjera:	Makinë pune;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	20 Qershor 2014.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke *përmendur pozicionin për të cilin aplikoni* në adresën e e-mail^{it}: recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.